



KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 136/5 prot.

Tiranë, më 3.4.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 739, datë 26.2.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Mimoza Margjeka
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 20.3.2024, është njoftuar vendimi nr. 739, datë 26.2.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Mimoza Margjeka, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 739, datë 26.2.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mimoza Margjeka, në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting, ushtronte detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe pranë

Gjykatës së Apelit, Korçë sipas një skeme delegimi. Në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Komisioni, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, ka vendosur fillimin e hetimit administrativ, nga ku janë administruar edhe raportet përkatëse nga institucionet ligjzbatuese.

3. Në datë 16.3.2023, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) ka paraqitur pranë Komisionit shkresën me lëndë: “*Gjetje dhe Mendim*”, me nr. *** prot., datë 16.3.2023¹, ku parashtrohet:

- Në lidhje me ekzistencën e një dënimi në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka për veprën penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, në bashkëpunim*”, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal, shpallur me vendimin e datës 15.12.2022 të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- Gjykata e sipërcituar ka dënuar subjektin e rivlerësimit me 4 vjet dhe 6 muaj burgim dhe ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit në përputhje me nenin 59 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Subjekti i rivlerësimit është vendosur në shërbim prove për një periudhë 3-vjeçare. Dhe e fundit, por jo për nga rëndësia, në bazë të nenit 35 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, subjektit të rivlerësimit i është hequr e drejta për të ushtruar funksione publike për 5 vjet.

- Vëzhguesi ndërkombëtar paraqet gjithashtu si *Gjetje shtesë* ekzistencën e një standardi ligjor, siç theksohet në vendimin nr. 28/2019 të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit ***, ***, sipas të cilit sjellja e subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

3.1 Vëzhguesi ndërkombëtar mendon se sjellja e subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë dhe se përmbajtja e vendimit të gjykatës bashkëngjitur këtij dokumenti duhet të konsiderohet nga Komisioni në vlerësimin e përgjithshëm të procesit të rivlerësimit.

4. Sa më sipër, Komisioni ka marrë në konsideratë dhe ka bërë pjesë të rezultateve të hetimit gjetjet dhe mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar, duke i çmuar të domosdoshme për procesin e rivlerësimit të subjektit Mimoza Margjeka, pasi subjekti i rivlerësimit është dënuar nga Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

5. Në përfundim, duke vlerësuar se sjellja e subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e saj, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit.

6. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, i kërkoi Komisionit pezullimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj saj deri në përfundimin e çështjes penale me një vendim të formës së prerë.

¹ Protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 16.3.2023.

7. Komisioni, në datë 4.5.2023, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, ka vendosur se duhet pritur/shtyrë procesi derisa Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të marrë vendim në lidhje me çështjen penale në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka, vendim i cili i është njoftuar edhe subjektit të rivlerësimit.

8. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka njoftuar² Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit se, në seancën gjyqësore të datës 12.12.2023, ora 10:30, pas relativitetit të palëve në seancë, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 15.12.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*

- *Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.*

9. Në vijim të sa më sipër, në datë 16.1.2024, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit ka paraqitur pranë Komisionit shkresën me lëndë: “*Gjetje dhe Mendim*”, me nr. ** prot., datë 16.1.2024³, rreth nevojës që Komisioni:

- *Të rifillojë dhe të përfundojë pa vonesa të panevojshme procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka, për shkak të pavarësisë së procesit të rivlerësimit nga procedimet e tjera të zakonshme disiplinore (dhe administrative). Duke bërë këtë, Komisionit i rekomandohet:*

- *Të administrojë si provë dy vendimet e sipërpërmendura në procesin aktual dhe t'i konsiderojë ato në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të procedurës*

10. Komisioni, i kërkoi⁴ Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vënien në dispozicion të kopjes së vendimit të mësipërm, e cila me shkresën nr. ***/* prot., datë 29.1.2024 ka përcjellë aktin “Shkurtim vendimi”, nr. 52, datë 12.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa me shkresën nr. ***/* prot., datë 13.2.2024, kjo gjykatë ka përcjellë aktin “Vendim”, nr. 52, datë 12.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

11. Sa më sipër, Komisioni, pas njohjes me vendimin e arsyetuar të sipërcituar, vendosi të njoftojë subjektin Mimoza Margjeka me rezultatet e hetimit administrativ dhe, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

12. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, midis të tjerash, ka deklaruar se: *[...] Nga ana juaj, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më është kaluar barra e provës për të provuar pafajësinë time për një çështje penale. Në procesin penal, barra e provës i takon*

² Me shkresën nr.*** prot., datë 12.12.2023

³ Protokolluar nga Komisioni me nr. ** prot., datë 16.1.2024.

⁴ Me shkresën *** prot., datë 18.1.2024.

prokurorit dhe, në rastin e dënimit me vendim të formës së prerë, është KLGJ-ja ajo që merr vendim për magjistratin sipas nenit 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kuptimi i vendimit gjyqësor i formës së prerë është përcaktuar në vendimin unifikues nr. 2, datë 3.11.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nuk parashikon procedurë rivlerësimi për gjyqtarin kur ai ndiqet penalisht dhe dënohet nga gjykata.

*Për sa i përket procedurës administrative, është e përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 1, shkronja “d”, të këtij ligji thuhet se: “Objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me: d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre. Dhe në këtë rast është organi i qeverisjes së gjyqësorit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili ka kompetencën **për të pezulluar magjistratin në rastin e një çështjeje penale dhe, në rast dënimi me vendim të formës së prerë, KLGJ-ja shkarkon magjistratin nga detyra.***

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 104 parashikon rastin e procedimit disiplinor për shkak të kryerjes së një vepre penale.

Sa më sipër rezulton se, procedura juaj administrative është mbivendosur me një procedurë tjetër administrative të ILD-së dhe KLGJ-së. Në këto kushte kërkoj nga ana juaj vazhdimin e pezullimit të procedurës së vlerësimit, e cila, në rast shkarkimi nga KLGJ-ja, do të ndërpritet. Bashkëngjitur ju dërgoj aktet e cituara në këtë shkresë që kanë të bëjnë me procedurën e ndjekur nga ILD-ja dhe KLGJ-ja” [...].

13. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni, bazuar në vlerësimin tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, e dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, (parashikuar nga neni 319/ç – 25 i Kodit Penal) ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

13.1 Sa më sipër, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: [...] *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Mimoza Margjeka, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës [...].*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

14. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

15. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

16. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

17. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

18. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi vendimin nr. 739/2024 dhe aktet shoqëruese të tij, çmon se vendimi është i cënueshëm dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohen edhe në vijim, Komisioneri Publik i referohet edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si organi i vetëm gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar në këtë proces.

19. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 739/2024 të Komisionit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

20. Referuar përmbajtjes dhe arsyetimit të vendimit nr. 739, datë 26.2.2024, Komisioneri Publik vlerëson të konsiderojë nëse vendimi i Komisionit është marrë në vlerësim të drejtë të situatës faktike e zbatim të drejtë të kuadrit kushtetues dhe ligjor dhe, në vijim, si duhet të veprojnë organet e rivlerësimit për këtë situatë faktike dhe kuadër kushtetues e ligjor.

21. Nga aktet në dosje të Komisionit, rezulton sa vijon:

21.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Mimoza Margjeka, në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting, ushtronte detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Durrës, si dhe pranë Gjykatës së Apelit, Korçë sipas një skeme delegimi. Në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

21.2 Me vendimin gjyqësor nr. 69, datë 15.12.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është vendosur: [...] *11. Deklarimi fajtores të të pandehurës Mimoza Margjeka për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë" e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 319/ç – 25 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e saj me 4 (katër) vite dhe 6 muaj burgim.*

12. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vuajtur të tij, duke e vënë të pandehurën Mimoza Margjeka në provë për një periudhë kohe prej 3 (tre) vitesh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë

tjetër penale si dhe të mbajë kontakte të rregullta me Zyrën e Shërbimit të Provës ku ka vendbanimin e saj.

13. Në zbatim të nenit 35 të K.Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurën Mimoza Margjeka për të ushtruar funksione publike për një afat kohor 5 vjeçar. [...]

21.2.1 Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 52, datë 12.12.2023 ka vendosur përfundimisht: [...] 1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 15.12.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. [...]

21.3 Komisioneri Publik, vëren se dënimi i gjyqtarit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, parashikohet drejtpërsëdrejti nga neni 140/2/b i Kushtetutës, si një ndër rastet kur gjyqtarit i jepet masa disiplinore: “Shkarkim nga detyra”, me vendimmarrje të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

21.4 Nga aktet në dosje të hetimit administrativ, nuk rezulton që Komisioni të ketë kryer korrespondencë me Këshillin e Lartë Gjyqësor lidhur me fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. Mimoza Margjeka. Gjithashtu, nuk rezulton që Komisioni t’i jetë drejtuar edhe institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si institucioni të cilin Kushtetuta në nenin 147/d, paragrafi i parë, e ngarkon me përgjegjësinë për të filluar procedimin disiplinor në ngarkim të magjistratëve, bazuar në rastet e parashikuara në Kushtetutë, neni 140.

21.5 Referuar akteve të përcjella nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës së përcjellë nga Komisioni rezulton se:

21.5.1 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr.***/* prot., datë 18.1.2024 me lëndë: “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistrates Mimoza Margjeka gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”, i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor me kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj veprimtarisë së magjistrates Mimoza Margjeka, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe neni 104, pika 3 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

21.5.2 Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr.***, datë **.1.2024, ka vendosur [...] 1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. ***,***, në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr. ***/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistrates Mimoza Margjeka, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës [...].

21.6 Komisioneri Publik, fillimisht nënvizon se ligjvënësit janë treguar të kujdesshëm që, në ndryshimet kushtetuese, të cilat sanksionuan zbatimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të parashikonin që institucionet e rivlerësimit, ushtrimin e kompetencës së tyre kushtetuese, ta kryenin në harmoni të plotë me institucionet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të cilat, këto të fundit, nuk pengoheshin të përmbushnin detyrimet e tyre kushtetuese apo të ishin në kushtet e mbivendosjes së

kompetencave, lidhur me procesin disiplinor ndaj magjistratëve në Republikën e Shqipërisë, gjatë ecurisë së mandatit të funksionimit të institucioneve të rivlerësimit.

21.7 Kështu, në nenin 179/b, paragrafi 7, Kushtetuta, shprehimisht, ka parashikuar se moskalimi me sukses i *procesit të rivlerësimit* përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës nga ana e magjistratit, ***krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë.***

21.8 Ky formulim i qartë i kësaj dispozite, u krijon mundësinë të dy juridiksioneve disiplinore, atij të jashtëzakonshëm (*institucioneve të rivlerësimit kalimtar*) dhe atij të zakonshëm (*Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Këshilla*) të funksionojnë njëkohësisht në ushtrim të kompetencës përkatëse kushtetuese, më konkretisht në rastet e mbarimit të ushtrimit të detyrës, sipas legjislacionit specifik që, ndër të tjera, rregullon posaçërisht për secilin juridiksion, procedurat e procesit, shkaqet e mbarimit të ushtrimit të detyrës/shkarkimit, ushtrimin e të drejtës së ankimit dhe gjykatën që e shqyrton etj.

21.9 Nëse juridiksioni i jashtëzakonshëm disiplinor, shkaqet e mbarimit të detyrës i ka të parashikuara në dispozitat e aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, juridiksioni i zakonshëm disiplinor, ato i ka të parashikuara në nenin 140, 148/d të Kushtetutës dhe pjesën përkatëse të ligjit nr. 96/2016.

21.10 Në rastet e parashikuara nga neni 140/2/b dhe 148/d/2/b i Kushtetutës, veprimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të kërkuar nga Këshillat marrjen e masës disiplinore për shkarkimin nga detyra të magjistratëve, sa kohë bazohet në ekzistencën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, që ka dënuar magjistratin për kryerjen e një krimi, duhet të pasohet nga një vendimmarrje e formës konstatuese nga ana e Këshillave⁵.

21.11 Kjo vendimmarrje konstatuese nga ana e Këshillave, në rastet e ekzistencës së një vendimi gjyqësor të formës së prerë, që dënon magjistratin për kryerjen e një krimi, është qartësisht e ndryshme nga vendimmarrja vlerësuese në themel, në rastet e kërkesave të paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas nenit 140/2/a dhe 148/d/2/a të Kushtetutës.

21.12 Në vijim të këtij argumenti, po t'i referohemi nenit 111 të ligjit nr. 96/2016, është lehtësisht e dallueshme se, teksa rendit shkaqet e dhënies së masës disiplinore: "*Shkarkim nga detyra*", ligjvënësi nuk i referohet shkakut të dhënies së kësaj mase disiplinore në rastet e ekzistencës së një vendimi gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sa kohë ky shkak parashikohet shprehimisht si i tillë dhe në mënyrë ezauruese në nenin 140/2/b e 148/d/2/a të Kushtetutës dhe nuk mund të përbëjë lëndë për diskrecionin vlerësues të Këshillave, sikundër përbëjnë shkaqet e parashikuara në nenin 140/2/a dhe nenin 148/d/2/a të Kushtetutës.

21.13 Krahasimisht, sa u trajtua më lart për juridiksionin e zakonshëm disiplinor, po aq edhe institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, brenda ushtrimit të kompetencës së tyre kushtetuese shprehen si me vendimmarrje që bazohet në shqyrtimin e themelit të çështjes së rivlerësimit për magjistratin, përkatësisht duke gjykuar mbi kriteret e pasurisë, profesionalizmit dhe figurës, ashtu edhe me vendimmarrje, që në thelb mbeten konstatuese të ekzistencës së një rrethane juridike, e cila sjell pasoja për ecurinë/ndërprerjen/përfundimin e procesit të rivlerësimit, të tilla si mbarimi i statusit të

⁵ Shihni vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.34/2017, prg. 58, lidhur me prg. 3.3.5.4.2.

magjistratit me vendim të Këshillave për shkak të: (i) dorëheqjes, (ii) pensionimit për shkak të arritjes së moshës, (iii) marrjes së masës disiplinore të “*shkarkimit nga detyra*” etj.

21.14 Këto vendimmarrje të natyrës konstatuese nga ana e institucioneve të rivlerësimit, të dhëna në ushtrim dhe brenda kompetencës së tyre kushtetuese të kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, janë një praktikë vijuese e që, në raste të caktuara, kanë gjetur interpretim edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si gjykata e procesit të rivlerësimit kalimtar.

21.15 Në rastin konkret, Komisioneri Publik, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit (vendimet e Kolegjit (JR) nr. 32/2021 dhe nr. 29/2021), çmon se në rastet e dënimit të magjistratëve me një vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, ushtrimi i kompetencës nga ana e institucioneve të rivlerësimit, për efekt të procesit të rivlerësimit, duhet të konkludojë me një vendim konstatues të ndërprerjes pa vendim përfundimtar të procesit, për sa kohë juridiksioni i zakonshëm disiplinor (Inspektor i Lartë i Drejtësisë, *Këshilli përkatës*) ka ushtruar kompetencën e tij, ashtu sikundër e detyron Kushtetuta, duke mbaruar statusin e magjistratit, për shkak të shkarkimit nga detyra.

21.16 Ndërkohë, në rastin konkret, duke e konsideruar ekzistencën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, që ka dënuar znj. Mimoza Margjeka për kryerjen e një krimi, si një shkak që kategorizohet sipas nenit 61/5 të ligjit nr. 86/2016 dhe passjell shkarkimin e saj nga detyra për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioneri Publik konstaton, se Komisioni, në interpretim të gabuar të dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, ekzistencën e rrethanës juridike të dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, e ka konsideruar si një shkak që lejon juridiksionin e jashtëzakonshëm disiplinor (*rivlerësimi kalimtar*) ta çmojë këtë rrethanë (*vendimin e formës së prerë të dënimit*), si një ndër rastet e shqyrtimit në themel të procedurës së rivlerësimit, duke e kategorizuar ekzistencën e saj, si një ndër rastet, kur shkarkimi nga detyra i magjistratit kryhet, bazuar në nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

21.17 Ushtrimi nga ana e Komisionit i kompetencës kushtetuese së kryerjes së procesit të rivlerësimit, duke sjellë si pasojë marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, bazuar në dënimin e magjistratit me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë ardhjen e pasojës kushtetuese (*shkarkimit nga detyra të gjyqtarit*), për shkak të mosveprimit të institucioneve të juridiksionit të zakonshëm disiplinor (*Këshilli i Lartë Gjyqësor*), të cilët Kushtetuta i detyron të veprojnë në rastin konkret, në përmbushje të kompetencës së tyre.

21.18 Brenda ushtrimit të kompetencës, që Kushtetuta i njeh institucioneve të rivlerësimit, Komisioni duhet të verifikonte dhe të administronte informacion nga institucionet kushtetuese të juridiksionit të zakonshëm disiplinor, të ngarkuar nga Kushtetuta për të ushtruar kompetencën e tyre të kryerjes së hetimit dhe procedimit disiplinor, me qëllim marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të znj. Mimoza Margjeka.

21.19 Ndodhur në këto rrethana kushtetuese, juridike dhe faktike, Komisioneri Publik çmon se juridiksioni kontrollues dhe rivlerësues i Kolegjit, do të duhet të ushtrohet për të hetuar se cila ka qenë vendimarrja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe në rast se, pas hetimit nga ana e Kolegjit, do

të rezultojë se institucionet e juridiksionit të zakonshëm disiplinor kushtetues e kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues dhe se është dhënë masa disiplinore: “*Shkarkim nga detyra*”, procesi i rivlerësimit për znj. Mimoza Margjeka do të duhet të deklarohet i përfunduar, pa një vendim përfundimtar, ashtu sikundër jurisprudenca e Kolegjit urdhëron në vendimmarrjet përkatëse, të përmendura më lart, në këtë ankim.

21.20 Në rast se, edhe gjatë hetimit të kryer nga ana e Kolegjit, për shkak të gjykimit të këtij ankimi, rezulton se institucionet që Kushtetuta i ngarkon me kompetencën e përmbushjes së juridiksionit të zakonshëm disiplinor kushtetues, janë ende në kushtet e mosveprimit, edhe për shkak të rolit kushtetues të parashikuar nga paragrafi 5, i nenit 179/b i Kushtetutës, zbatimi i drejtpërdrejt nga ana e Kolegjit i dispozitës së nenit 140/2/a të Kushtetutës, për efekt të kryerjes së procesit të rivlerësimit, do të duhet të sjellë të njëjtën pasojë, deklarimin e përfunduar të procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

IV. Kërkimi i ankimit

22. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të ligjit dhe provave të administruara;

23. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt me Komisionin;

24. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe për znj. Mimoza Margjeka, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 739, datë 26.2.2024, të Komisionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

- Të deklarohet të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Mimoza Margjeka, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ka humbur statusin e magjistratit.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO